



Pranimë / Dorezuar / Prijmljeno / Predato / Received / Delivered	08 - 06	2021	1	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org / Unit	Nr Prot / Br Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKIMBETEK	2965/2021		113	



Republika e Kosovës

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.363/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikja Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 06.05.2021 me numër A.nr.363/2021 të parashtruar nga ankuesi me adres rruga "Sadedin Hajda", pa numër Komuna e Rahovecit, kundër organit të punësimit - Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08/06/2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa me A.nr.363/2021e datës 06.05.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Ndryshim- Plotësimi i Akt emërimit i datës 02/10/2013 me Nr.P. 4023.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Rahovecit, që brenda afatit prej 15 ditësh të bejë zbatimin e këtij vendimi, duke i njohur ankuesit të drejtën e realizimit të pagës sipas Ndryshim plotësimi të Akt Emërimit të dates 02/10/2013 me Nr.P. 4023, dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 06/05/2021 e deri në zbatim të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Rahovecit, në pozitën e punës "Zyrtarë për shpenzime", me koeficient 7.5 sipas Ndryshim-Plotësimit të Akt emërimit të datës 02/10/2013 me nr. 4023, në Drejtorinë për financa dhe Buxhet, i pa knaqur me mos pagesën e plotë sipas koeficientit 7.5 nga Komuna e Rahovecit, ka parashtruar ankesë me datë 06/05/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 21.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Rahovecit. Më datë 02.06.2021 Komuna e Rahovecit, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2213/2021 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshim-Plotësimi i Akt emërimit i datës 02.10.2013 me nr. 4023; Lista e pagave nga data 01.11.2013 deri me datë 30.11.2013 dhe nga 01.02.2021 deri me datës 21.02.2021; Akt emërimi i datës 11.05.2012 me nr.2112; Përgjigje në ankesë e datës 02.06.2021 nr. Protokoll 2789/2021; Vendimi nr. 4022 i datës 02.10.2013 lëshuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit; Përshkrimi detyrave të punës i datës 30.09.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të dorëzuara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është pjesërisht e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi, me datë 11.10.2013 ka nënshkruar Ndryshim-Plotësimin e Akt Emërimit me numër protokoll 01Nr.4023 për pozitën e punës "Zyrtarë për shpenzime", me koeficient të pagës 7.5.

Ankuesi edhe pse i është caktuar koeficienti i pagës shtatë pikë pesë (7.5), i njëjti përmes parashtrimit të pretendimeve ankimore ka deklaruar se realizon pagën sipas koeficientit shtatë (7). Lidhur me këtë çështje, ankuesi, me datë 06.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 223/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka bërë përpjekje në Komunë të Rahovecit që të realizoj këtë të drejtë, dhe për shkak të mos realizimit të kësaj kërkesë përkatësisht realizimit të pagesës së diferencës 0.5 të koeficientit të pagës sipas aktemërimit aktual, e cila në përgjigjen në ankesë të datës 02.06.2021 nr. protokoll 2789/2021 që ka dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është arsyetuar se nuk ka buxhet të mjaftueshëm për këtë diferencë të koeficientit por se nuk ka pasur ndonjë arsye tjetër sa i përket këtij pretendimi ankimor në lidhje me realizimin e kësaj kërkesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar Komuna e Rahovecit me rastin e mos pagesës së diferencës 0.5 të koeficientit të pagës, e cila është arsyetuar se nuk ka buxhet të mjaftueshëm, nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sepse në kohën kur ankuesi e ka nënshkruar Ndryshim-Plotësimin e Akt Emërimit në pozitë: "Zyrtarë për shpenzime", me numër protokoll 01Nr.4023.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 9 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës", si dhe duke marr parasysh se ankuesi ushtron pozitën e punës "Zyrtarë për shpenzime", sipas Ndryshim- Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli 01Nr.4023 të datës 11.10.2013 me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e pagës sipas ndryshim-plotësimit të akt emërimit në fuqi, me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), është i bazuar, kështu që organi i punësimit, gjegjësisht Kryetari i Komunës së Rahovecit është i obliguar të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që ankuesit ti realizojë pagën sipas ndryshim-plotësimit të Aktit të Emërimit për pozitën përkatëse, dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 06.05.2021, kur ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës, në mënyrë retroaktive nga data 02.10.2013, kur ankuesi e ka nënshkruar ndryshim-plotësimin e akt emërimit, është i pa bazuar sepse, ankuesi me datë 02.10.2013 e ka nënshkruar ndryshim-plotësimin e Aktit të Emërimit me numër protokolli 4023, ndërsa të njëjtit nuk i është realizuar mbi bazë të koeficientit 7.5 pagesa dhe se tashmë ankuesi i ka tejkaluar afatet ligjore sa i përket realizimit të kompenzimit retroaktivë nga koha e ndryshim-plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 02.10.2013.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.363/2021, datë 08/06/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI
Procesmbajtëse

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Rahovecit,
- Arkiviot të KPMSHCK- së.